

Për:	Operatorë Ekonomik: BERISHA COM SH.P.K me adresë në GJAKOVË Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	08.05.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1.1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim, të datës: **06.05.2025**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **BERISHA COM SH.P.K.** me adresë në **GJAKOVË**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Asfaltimi i rrugës Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastasel – Polluzhë**, me Numër të prokurimit: **623-25-1580-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-026-5-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **BERISHA COM SH.P.K.** me adresë në **GJAKOVË**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Asfaltimi i rrugës Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastasel – Polluzhë**, me Numër të prokurimit: **623-25-1580-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-026-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **28.04.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **Asfaltimi i rrugës Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastasel – Polluzhë**, me Numër të prokurimit: **623-25-1580-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-026-5-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **BERISHA COM SH.P.K.** me adresë në **GJAKOVË**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Asfaltimi i rrugës Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastasel – Polluzhë**, me Numër të prokurimit: **623-25-1580-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-026-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **28.04.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **06.05.2025**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza ligjore e kërkesës

- Në lidhje me pretendimin ankimor se kërkesa që **“Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët në prezencë të noterit është kërkesë diskriminuese”**, sqarojmë se kjo kërkesë krijon siguri të marrëveshjeve për makineritë dhe vlen për të gjithë kompanitë prandaj nuk mund të quhet diskriminuese për ndonjë kompani e favorizuese për ndonjë tjetër.
Rregullore Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nuk shkruan askund që është obligative të largohen noterizimet, ndërsa fjala e panevojshme nuk është obligative, kurse ne për të shmangur mundësinë e verifikimeve të shumta të dokumenteve kemi menduar që disa dëshmi të janë të noterizuara dhe mendojmë se kjo kërkesë nuk paraqet ndonjë problem për kompanitë dhe nuk paraqet shpenzime të mëdha, prandaj konsiderojmë se kjo kërkesë më shumë ka të bëjë me efikasitetin e procedurës së prokurimit, që të mos ketë vonesa në verifikime të ndryshme të dokumenteve, prandaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.
- Në lidhje me pretendimin e Operatori Ekonomik ankues se Buldozer D6 me ripër duhet të kërkohet me peshë e jo me tip të prodhimit D6 dhe se këto pajisje i prodhon vetëm Komatsu, sqarojmë se D6 tregon për madhësinë dhe fuqinë e makinerisë në fjalë, prandaj pretendimi i OE ankues është i pabazuar. Ndërsa sa i përket pretendimit që këtë lloj makinerie e prodhon vetëm Komatsu, OE ankues nuk ka ofruar asnjë dëshmi që të argumentojë pretendimin në fjalë.
- Në lidhje me pretendimin e OE ankues se Gjysëmrimorkio për bartjen e automjeteve të rënda min. pesha 75-90 ton është kërkesë e panevojshme dhe kufizuese, sqarojmë se edhe ky pretendim nuk është argumentuar në asnjë mënyrë përse është kufizues kjo kërkesë. Tonazha e kërkuar përkon me natyrën dhe qëllimin e këtij tenderi dhe është përcaktuar hapësirë e mjaftueshme e tonazhës ndërmjet minimumit dhe maksimumit.
- E njëjta arsye vlen edhe ndaj pretendimit ankimor për Grejderin me repera dhe llaser digjital.

Duke pasur parasysh të gjitha pozicionet e përcaktuara në paramasë janë kërkuar edhe makineritë dhe specifikimet e tyre, prandaj në këto raste lejohet të shfrytëzohen edhe kapacitetet e kompanive të tjera me marrëveshje ashtu siç e përcakton edhe Neni 69 paragrafi 8 ku ceket decidivisht që **“Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta”**.

Nga ky nen kuptojmë që operatorët ekonomik mund të bashkëpunojë me operatorë të tjerë gjegjësisht të merr pajisje me qira për të plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit.

Po ashtu mund të ofertohet edhe në grup pasi që neni 71 i LPP e përcakton dhe lejon një gjë të tillë, kështu që operatorët ekonomik mund të bëjnë zgjidhje në kuadër të dispozitave të LPP për të plotësuar njëri tjetrin dhe për të ofertuar bashkërisht me kapacitete që i kanë secila kompani.

- Në lidhje me dronin e kërkuar dhe kontestimit nga ana e OE ankues, sqarojmë se droni është kërkuar sepse nevojiten matje dhe hartografi me saktësi më të lartë dhe mund të operojnë në kushte të ndryshme mjedisore. Realisht vetëm është përshkruar kërkesa për dron dhe vetëm është kërkuar që të ndryshohet kjo kërkesë pa dhënë ndonjë argument apo arsyetim konkret se përse duhet të ndryshohet kjo kërkesë dhe se çfarë pajisje mund të vendoset në vend të dronit, prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar. Është kontestuar rezolucioni jo më pak se 60 megapiksel duke tentuar ta shfaqin si specifikim diskriminues veçanërisht për ata që nuk kanë në dispozicion pajisje të tilla, mirëpo ne sqarojmë se rezolucioni jo më pak se 60 megapiksel është specifikim që përcakton minimumin e specifikës dhe në treg ka dronë të ndryshëm me 60 megapiksel, andaj nuk mund të quhet diskriminues. Sa i përket përcaktimit të mundësisë për matje me PPK (Post Processing Kinetamik), sqarojmë se kjo metodë është më e sofistikuar për përmirësim të saktësisë së të dhënave dhe kjo matje është shumë më e saktë se sa GPS standard, e cila ka disa përparësi të ndryshme siç është eliminimi i devijimeve të cilat mund të shkaktohen nga atmosfera, nuk ka nevojë për lidhje me bazën dhe se funksionon shumë mirë në zona të izoluara duke qenë i përshtatshëm për terren ku sinjali i rrjetit nuk funksionon mirë.
- Në lidhje me pretendimin e OE ankues se është shqetësuese publikimi i të njëjtës dosje në disa procedura të aktivitetit nga Komuna e Rahovecit sqarojmë se hartimi i dosjes së tenderit është përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues varësisht nga natyra e aktivitetit të prokurimit dhe specifikave të tjera në projektet e ndryshme, prandaj publikimi i dosjes me kërkesa për afërsisht të njëjta bëhet në këto rast kur natyra e tenderëve është pothuajse e njëjtë apo e përafërt. Dosja e hartuar në këtë mënyrë nuk bie në kundërshtim me ndonjë dispozitë të LPP e po ashtu OE ankues nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se dosja bie në kundërshtim me ndonjë dispozitë të LPP, prandaj pretendimi ankimor është i pa bazuar dhe i pa argumentuar.

- Në lidhje me pretendimin se kemi të bëjmë me shkelje të nenit 7 të LPP për favorizim të kompanive të caktuara, sqarojmë se kur kem parasysh paramasën dhe natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit si dhe kur kem parasysh faktin se ky tender është ndërkombëtar e ku mund të ofertojnë edhe kompani ndërkombëtare, përveç atyre vendore atëherë mundësia është e hapur për formim të grupeve të operatorëve ekonomik si vendor ashtu edhe ndërkombëtar, prandaj nuk ekziston asnjë favorizim për ndonjë kompani të caktuar.
- Edhe sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 28 të LPP-së, sqarojmë se edhe ky pretendim nuk ka mundur të arsyetohet në asnjë mënyrë dhe me fakte se përse ka shkelje të kësaj dispozite sepse specifikimet teknike të vendosura për pajisje nëse nuk mund të plotësohen vetë nga një OE atëherë është mundësia e ofertimit në grup me qëllim të plotësimit të kërkesave dhe specifikave teknike. Ashtu siç u cek më lartë edhe neni 69 është respektuar e ku OE mund të mbështeten tek kapacitetet e OE tjerë për të plotësuar kërkesat dhe dëshmitë në lidhje me tenderin përkatës.
- Pretendimi i OE ankues për shkelje të nenit 6 të LPP është pretendim i pa bazuar pasi që ekonomiciteti nuk mund të vie në shprehje kur kemi të bëjmë me kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë prandaj edhe ky pretendim është i pa bazuar.

Duke patur parasysh sqarimet dhe përgjigjet në lidhje me pretendimet ankimore kërkesa për rishqyrtim refuzohet si e pabazuar.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>